

V E N D I M
Nr.207, datë 4.5.1993

PËR ÇMIMIN E SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Me propozimin e Ministrisë së Industrisë, të Burimeve Minerare dhe Energjitike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vartësi nga gjendja teknike e rrjetit elektrik caktohen zonat dhe kufijtë normativë të përdorimit të energjisë elektrike për përdoruesit familjarë si më poshtë:

- Zona e parë përfshin qendrat e banuara me gjendje teknike të mirë të rrjetit elektrik. Kufiri normativ caktohet 250 kilovat-orë në muaj.

- Zona e dytë përfshin qendrat e banuara me gjendje teknike jo aq të mirë të rrjetit elektrik. Kufiri normativ caktohet 150 kilovat-orë në muaj.

- Zona e tretë përfshin qendrat e banuara me gjendje teknike të dobët të rrjetit elektrik. Kufiri normativ caktohet 70 kilovat-orë në muaj.

Të drejtën e përfshirjes në zonat e mësipërme të qendrave të banuara, si dhe ndryshimet që do të bëhen në varësi nga gjendja teknike e rrjetit elektrik, e ka Korporata Elektroenergjitike Shqiptare.

2. Çmimi i shitjes me pakicë i energjisë elektrike për përdoruesit familjarë brenda kufijve normativë, sipas zonave të mësipërme, është 0.50 lekë për çdo kilovat-orë.

Çmimi i shitjes me pakicë i energjisë elektrike për sasi të tej kufijve normativë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, caktohet:

a) kur përdorimi mbi normat është deri në 50 kilovat-orë, çmimi caktohet 1 lekë për çdo kilovat orë;

b) kur përdorimi e kalon kufirin prej 50 kilovat-orësh sipas shkronjës "a", çmimet caktohen:

- për periudhën prill-tetor 1,5 lekë për çdo kilovat-orë të tejkaluar;

- për periudhën nëntor-mars 3 lekë për çdo kilovat-orë të tejkaluar.

3. Çmimi i shitjes me pakicë i energjisë elektrike që përdoret nga konsumatorët e tjerë jofamiljarë, të jetë 1,8 lekë për çdo kilovat-orë.

4. Ndërmarrjeve të sistemit elektroenergjitik u lind e drejta të bëjnë ndërprerjen e energjisë elektrike pas kalimit të afatit 5 ditor të njoftuar me shkrim prej tyre, kur:

a) nuk lidhet kontratë për përdorimin e energjisë elektrike;

b) përdoruesit shtojnë fuqinë e vendosur pa miratimin e tyre;

c) pajisjet dhe instalimet elektrike janë jashtë rregullave të shfrytëzimit dhe standardeve shtetërore;

ç) nuk paguajnë energjinë elektrike të përdorur sipas afateve të caktuara në kontratë.

Të drejtën e shtyrjes së afatit 5 ditor pas njoftimit e ka në kompetencë Korporata Elektroenergjitike.

Për rastet e mësipërme, lidhja e energjisë elektrike bëhet nga ndërmarrjet e sistemit elektroenergjitik, brenda 24 orëve nga koha kur përdoruesi i energjisë ka plotësuar kërkesat e ndërmarrjes.

5. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.326, datë 28.8.1991 "Për ndryshimin e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike", nr.527, datë 11.12.1992 "Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.326, datë 28.8.1991", nr.414, datë 15.9.1992 "Për ndryshimin e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e tjerë jofamiljarë", nr.205, datë 23.6.1990, si dhe aktet e tjera nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet nga data 1.5.1993.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi